

AS UJIT
NK-1201-11P5
bt 30/10/2018



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
KESHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman

VENDIM

Nr 18 Datë 25/10/2018

Miratimin e lejes se përdorimit të burimit ujore te perrenjeve Kamicanit dhe te Bistes, dege te lumit Holtes dhe e lumit Devoll, për prodhim hidroenergjie subjektit "IDI 2005" sh.p.k në Bashkine Gramsh qarku Elbasan

Në mbështetje te ligjit 111/2012 "Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore" i ndryshuar me ligjin nr 6/2018 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin 111/2012 "Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore" neni 5, neni 12 pika 1, neni 13 pika 2 d, neni 50 pika 2. Vendimit Nr 416 date 13.05.2015 Keshillit te Ministrave "Per miratimin e kushteve te pergjitheshme e te posacme, dokumentave shoqeruese, afatit te vlefshmerise, formularve te aplikimit per autorizim dhe leje, procedurave te shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve te autorizimit e lejes per perdorim te burimeve ujore". Vendimit te Keshillit Kombetare te Ujit Nr 5 date 16.02.2016 "Per miratimin e rregullores "Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Basenit Ujore si dhe Vendimi te Keshillit Kombetare te Ujit Nr 6 date 16.02.2016 "Per miratimin e rregullores "Per funksionimin e Agjencise se Basenit Ujore"
Keshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman.

VENDOSI:

Miratimin e lejes se përdorimit të burimit ujore te perrenjeve Kamicanit dhe te Bistes, dege te lumit Holtes dhe e lumit Devoll, për prodhim hidroenergjie subjektit "IDI 2005" sh.p.k në Bashkine Gramsh qarku Elbasan

HEC KAMICANIT

Vepra e marrjes Nr1

X=441034 Y=4536782 Z=820 m

- Prurja mesatare 0.437 m³/sek.
- Prurja llogaritese: 0.55 m³/sek.
- Prurja ekologjike: 0.06 m³/sek.

Vepra e marrjes Nr2

X=440717 Y=4537062 Z=820m

- Prurja mesatare 0.104 m³/sek.
- Prurja llogaritese: 0.15 m³/sek.
- Prurja ekologjike: 0.04 m³/sek.

Godina e centralit

X=438731 Y=4532187 Z= 4885 m

Fuqia e instaluar e Hidrocentralit do te jete rreth 1860 kW


Per përdorimin e këtij burimi ujor duhet të plotësohen kushtet e mëposhme:

- Të mos cenohet furnizimi me ujë të popullatës dhe të industrisë për nevojat e tanishme dhe të prespektives.
- Të zbatohet grafikun për vaditje në kohë (ditë) dhe në sasi (l/s) për çdo vit të hartuar nga Bordet e Kullimit të pushtetit vendor dhe atë Qendror.
- Të respektohet grafikun e vaditjes edhe jashtë periudhës kur e kërkon Bordi i Kullimit.
- Të respektohet rrjedhja ekologjike.
- Si dhe duke plotësuar kushtet e përcaktuara nga institucionet qendrore dhe lokale.

Ngarkohet ABU Seman për zbatimin e këtij vendimi.

PËRGJEGJËSI ABU SEMAN

Isuf Myrtaj



KRYETARI I KBU SEMAN

Baki BALA

